



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 9.3. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, Anton Quni, Ganimete Musliu dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Peci- KIPRED; Blend Zyrap- KIPRED; Dhurata Kryeziu- OSBE; Visar Rushiti- GAP; Milot Rexhepi- DCAF.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të datës 4.2.2016;
3. Raportimi i komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për raportin vjetor të punës për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të datës 4.2.2016

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Raportimi i komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për raportin vjetor të punës për vitin 2015

Kryesuesi- Theksoi se për të raportuar në Komision, sipas ligjit, është ftuar komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për raportin vjetor të punës për vitin 2015. Fjalën ia dha komandantit, duke vazhduar tutje me pyetjet e anëtarëve të Komisionit.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama- Sa i përket raportit vjetor të punës për vitin 2015, theksoi se është i bazuar në objektivat e ministrit të FSK-së dhe direktivën e komandantit të FSK-së. Më tutje, theksoi se objektivat e përcaktuara nga ministri kanë qenë gjashtë, në bazë të cilave është zhvilluar direktiva në zhvillimin e FSK-së.

Objektivi i parë- mirëmbajtja e kapaciteteve operacionale, gatishmëria e Forcës.

Objektivi i dytë- mbështetja e institucioneve, OJQ-ve dhe komuniteteve.

Objektivi i tretë- programi i partneritetit me Ajova-n dhe NLAT.

Objektivi i katërt- bashkëpunimi me vendet e rajonit.

Objektivi i pestë- implementimi i rekomandimeve të RSSS-së.

Objektivi i gjashtë- funksionalizimi i Njesisë rajonale të kërkim-shpëtimit dhe Qendra e Ekselencës.

Më tutje, theksoi se nga gjashtë objektivat, katër nga to janë realizuar plotësisht, ndërsa dy janë në proces.

Bazuar në raportet e gjendjes operacionale të njësive dhe aktiviteteve që kemi pasur gjatë këtij viti, është arritur të mbahet ky operacionalitet dhe të zhvillohet dhe rritet niveli i gatishmërisë në të gjithë Forcën. Duke marrë për bazë këtë gatishmëri, në trajnimet e realizuara gjatë vitit 2015, fokusimi ka qenë në trajnime bazike, specialiteti dhe zhvillimi profesional i oficerëve dhe të nën-oficerëve. Gjithashtu, të gjitha trajnimet kolektive, janë bërë të bazuara në kërkesat e njësive në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, kryesisht në kurset bazike dhe specialistike dhe të gjitha shkathtësive, të bazuara në misionin që ka FSK-ja.

Sa i përket trajnimeve individuale, janë zhvilluar, kurse në vitin 2015 është angazhuar edhe komponenti rezervë, ku 75 pjesëtarë nga pjesa rezervë kanë qenë pjesë e trajnimeve.

Seminare dhe trajnime jashtë vendit për vitin 2015, duke marrë për bazë edhe marrëveshjet bilaterale që kemi me 12 shtete, janë realizuar 117 trajnime, falë bashkëpunimit me shtetet që kemi.

Vlen të theksohet se që nga viti 2015, për herë të parë jemi pjesë e shkollave të NATO-s, ku gjatë vitit që kaloi, 22 pjesëtarë të FSK-së kanë përfunduar trajnimet dhe kurset, bazuar në kërkesat tona dhe me aprovimin e shkollave të NATO-s. Trajnime në SHBA dhe shtete të tjera, gjatë vitit 2015, kanë qenë rreth 85 aktivitete të ndryshme. Aktualisht, në shkollime më afatgjate, janë 34 kadetë në katër vende anëtare të NATO-s, në Gjermani 2, në Turqi 19, në Kroaci 2 pjesëtarë dhe 11 në Maqedoni, që janë nga komunitetet dhe të tjerë. Në këtë vit, do të përfundojnë trajnimin, për herë të parë, në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, 3 pjesëtarë nga minoritetet, ku dy prej tyre janë serbë dhe 1 nga komuniteti boshnjak. Më tutje, theksoi se në kuadër të FSK-së, i është kushtuar rëndësi pjesëtarëve nga komunitet tjerë, për të cilët janë organizuar kurse të gjuhës shqipe, me qëllim të lehtësimit të punës së tyre. Aktualisht, në SHBA është duke kryer trajnimin një instruktore nga komuniteti boshnjak dhe së shpejti do ta përfundojë këtë trajnim. Ndërsa, sa i përket trajnimeve kolektive, kemi marrë pjesë në tre ushtrime fushore, duke filluar nga Shqipëria, pastaj me Slloveninë, Kroacinë, Maqedoninë. Po ashtu, kemi marrë pjesë edhe në trajnime brenda Kosovës, bashkë me ushtrinë amerikane. Procesin e rekrutimit të kadetëve për vitin 2015, i cili në fakt ka filluar në vitin 2014 dhe është bërë përzgjedhja, ku janë përzgjedhur 334 rekrutë të rinj, 305 meshkuj, 29 femra, ndërsa 17 nga ta janë nga komunitetet. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2015, kemi bërë përzgjedhjen e 28 kadetëve, ku 23 prej tyre janë meshkuj, 5 femra, prej të cilave dy janë nga radhët e komuniteteve. Në Qendrën Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë përzgjedhur 12 kadetë. Gjithashtu, vlen të theksohet se në marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë, janë dy kadetë nga Shqipëria, që janë pjesë e Qendrës Universitare të FSK-së. Ndërsa, janë 5 pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë filluar Akademinë Mjekësore në Turqi. Po ashtu, në Akademinë Ushtarake janë dy kadetë, të cilët janë me gradën nënoficerë. Pra, në total, janë 7 pjesëtarë në Akademinë Ushtarake në Turqi. Në Maqedoni, janë dy pjesëtarë, si dhe në Gjermani e Kroaci.

Gjithashtu, edhe në Akademinë Mbretërore të Britanisë së Madhe i kemi dy pjesëtarë dhe kemi rastin e fundit, ku kadeti Ismail Hoxha është treguar i suksesshëm, i cili ka marrë “Shpatën e Nderit”. Në bazë të performancës dhe në bashkëpunim me SHBA-të, janë dy kandidatë seriozë, që këtë vit, do të jenë pjesë e akademisë më prestigjioze, West Point.

Ndërsa, sa i përket infrastrukturës, që ka qenë një prioritet, gjatë vitit 2015, duke marrë për bazë edhe projektet e filluara në vitin 2014, janë përfunduar në vitin 2015. Janë të projektuara edhe dymbëdhjetë projekte të tjera në fushën e infrastrukturës, që kanë filluar në vitin 2015 dhe disa pritet që të përfundojnë në vitin 2016, dhe se vlera e tyre në total është 3.3 milionë euro.

Sa i përket mbështetjes së institucioneve, qoftë edhe organizatave joqeveritare dhe komuniteteve, gjatë vitit 2015, FSK-ja gjithmonë ka qenë e gatshme që në çdo kohë të kryejë misionin që ka dhe t’u dalë në ndihmë, të gjithë qytetarëve, pa dallim. Ne kemi arritur, që varësisht prej analizave dhe kërkesave, është bërë një punë e jashtëzakonshme dhe janë përfunduar diku 19 projekte humanitare. Ndërsa, sa i përket ekipeve mjekësore të FSK-së, me marrëveshje kemi që dy herë në muaj, në dy komuna të jepet përkrahje, sidomos komunitetit serb, në fshatrat e Komunës së Istogut, Novobërdës, varësisht nga nevojat që kanë, u jepen ndihmat esenciale. Ndërsa, sa i përket vetëdijesimit kundër minave të pashpërthyer, për çdo vit, bazuar në planin tonë, pra në ato komuna që vlerësohet dhe kemi informacionet që janë më të rrezikuara nga mjetet e pashpërthyer, ne kemi bërë disa aktivitete, ku është bërë vetëdijesimi në komunitete dhe shkolla, me qëllim të njoftimit për rreziqet që iu paraqiten ndaj mjeteve të pashpërthyer. Bashkëpunim kemi pasur edhe me organizatat e ndryshme, si dhe vizita të ndryshme, ligjërata nga ana ime dhe prestarët e tjerë të FSK-së, me qëllim për t’i njoftuar me aktivitetet e FSK-së.

Përkrahje i është dhënë edhe Komisionit për personat e zhdukur, në fshatin Rezallë-Skenderaj dhe në Çikatovën e Vjetër-Drenas. Aktivitet kryesor i yni dhe që e llogarisim si operacion human, në vitin 2015, njësitë që janë në shërbim të qytetarëve për çështjen e deminimit, kanë pasur 301 raste, ku është intervenuar dhe janë demoluar 441 mjete eksplozive. Po ashtu, edhe në këtë vit do të vazhdohet me projektet me prioritet.

Janë realizuar disa intervenime reale të njësive specialistike të FSK-së, siç janë operacionet e kërkim-shpëtimit, vërshimet dhe incidentet e ndryshme. Gjithsej janë nëntë operacione reale që janë realizuar. Gjithashtu, edhe me inspektimin e fushave të mbrojtjes kimiko-atomike biologjike, janë realizuar 15 operacione, ku kryesisht këto ndodhin në ish-fabrikat që kanë prodhuar dhe që vlerësohet se kanë pasur përbërje kimike.

Gjithashtu, si pjesë e aktiviteteve ka qenë vlerësimi i rrezeve të mundshme me njësinë kuadër të FSK-së, e cila është e specializuar, ku janë realizuar 11 operacione. Njësia bën vlerësimin e rrezeve, por këto çështja janë pjesë e komuniteteve në nivele komunale dhe se FSK-ja shërben në ndërlidhje me të gjitha komunat e Kosovës, përveç në pjesën veriore të Kosovës.

Janë realizuar katër aktivitete zjarfikëse, si dhe pesë operacione gjatë reshjeve të borës, kryesisht në fshatrat që jetojnë në vise të larta.

Ndërsa, operacione të tjera të kërkim-shpëtimit, që janë realizuar brenda dhe jashtë vendit, theksojmë që në fillim të vitit 2015, kemi pasur një intervenim dhe përkrahje në Shqipëri, në Komunën e Lipjanit në operacionin e kërkim-shpëtimit me rastin e humbjes së jetës së një fëmije 12 vjeçar.

Operacion tjetër i kërkim-shpëtimit është realizuar në lumin Ibër, ku janë gjetur dy trupa të pajetë, si dhe operacionin e nxjerrjes së veturës në lumin Badovc.

Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit me partnerët dhe Programit të Partneritetit me Ajova-n dhe ekipet këshilluese të NATO-s, theksoi se Ministria e FSK-së, deri më tani ka nënshkruar 12 marrëveshje bilaterale dhe se janë në fazën përfundimtare të nënshkrimit edhe të pesë marrëveshjeve bilaterale, ku dhjetë prej tyre janë shtete anëtare të NATO-s dhe të tjerat janë partnere të NATO-s.

Më tutje, theksoi se në vitin e kaluar, për herë të parë është mbajtur “Konferenca e FSK-së dhe partnerët”. Qëllimi ka qenë që të ftohen të gjithë partnerët dhe kanë qenë pjesë e ushtrimit fushor “Shqiponja 4”. Qëllimi i konferencës ka qenë, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe se në fillim të muajit prill, të këtij viti, do të mbahet konferenca e radhës dhe se bashkë me partnerët tanë, jemi në realizimin marrëveshjeve bilaterale. Konferenca e radhës do të jetë, më 5 prill, ku do të bashkërendohen veprimet për vitin 2016, 2017 dhe 2018.

Ndërsa, sa i përket zgjerimit të bashkëpunimit, i cili ka qenë njëri ndër objektivat e ministrit të FSK-së, i është kushtuar rëndësi bashkëpunimit me gardën nacionale të Ajova-s dhe se në koordinim me Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, janë realizuar rreth dyzetë e pesë aktivitete, duke e konsideruar marrëveshjen dhe bashkëpunimin me Ajova-n, si më të suksesshmin. Gjithashtu, jemi në përgatitje të draftit të zhvillimit të karrierës dhe janë realizuar trajnime të tjera të zhvillimit strategjik, të doktrinave, si dhe të fatkeqësive natyrore.

Ndërsa, sa i përket donacioneve të pranuara gjatë vitit 2015 dhe disa vazhdojnë në vitin 2016, vlen të theksohet se është nënshkruar marrëveshja 9.2 milionë \$(dollar) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe kryesisht, do të jenë pajisje të komunikimit, të bazuara në ekspertizat që janë bërë. Po ashtu, mendojmë që më 2015 dhe 2017, të përfundojë ky projekt dhe mund të konsiderojmë që si FSK do të jemi më të avancuar në rajon, sa i përket pajisjeve të komunikimit, duke iu falënderuar përkrahjes. Gjithashtu, janë ofruar donacione edhe tek njësitë specialistike,

nga Turqia dhe nga SHBA-të. Ndërsa, sa i përket Fondit të Mirëbesimit të NATO-s, është ndarë një shumë e caktuar në infrastrukturë dhe pajisje të caktuara, por është edhe donacioni nga shteti turk, që bazuar në marrëveshje, do të kemi 1 milion \$(dollar) për çdo vit dhe pa buxhetin aktual, do të jenë 2.5 milionë \$(dollar) që do të bëjmë marrëveshje bazuar në nevojat dhe kërkesat tona, që do të blihen disa pajisje ushtarake dhe është nënshkruar marrëveshja edhe për vitin 2016.

Sa i përket bashkëpunimit me vendet e rajonit, theksoi se janë në bashkëpunim të ngushtë, qoftë në shkëmbim të informacionit, por edhe të marrëveshjeve bilaterale në trajnime të ndryshme, ndërsa vlen të theksohet pjesëmarrja e FSK-së në “*Join Reaction 2015*”, pjesëmarrja në ushtrimin fushor “*Immediate Response*” në Slloveni dhe Kroaci, pjesëmarrja në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes, “Karta e Adriatikut 5” në Maqedoni, ku Kosova është ftuar në cilësinë e vëzhguesit.

Po ashtu, kemi marrë pjesë në Konferencën e Mynihut “Euro-Defence Summit” në Bruksel, pjesëmarrja në takimin e drejtorëve të politikave të mbrojtjes në Kartën e Adriatikut 5, në Bosnjë dhe Hercegovinë, Konferencën për Siguri në Evropë në Komandën e Evropës (US-Army Europe), si dhe pjesëmarrja në konferencën vjetore të shteteve të Evropës për forcat tokësore në Viesbaden- Gjermani.

Objektiv tjetër, i cili është realizuar pjesërisht, pas rekomandimeve të dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë për FSK-në, kanë dalë detyra, të cilat në të ardhmen FSK-ja do t’i ketë, për këtë qëllim është filluar planifikimi, kurdo që vendimi politik të merret për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Bashkë me ekipet profesionale nga Shtetet e Bashkuara, është punuar bashkërisht në procesin e planifikimit. Më tutje, theksoi se janë në përfundim të draftit të planit afatgjatë dhe se në kuadër të kësaj janë bërë tre kurse të veprimit dhe mendohet që në fazën e parë, pas vendimit për transformimin e FSK-së, të jemi të gatshëm të marrim të gjitha masat, bazuar në rekomandimet e dala nga Analiza e RSSS-së dhe në katër misionet kryesore që do të ketë FSK-ja. Qëllim dhe synim është mbajtja e kapaciteteve aktuale, dhe më pas, të vazhdohet me prioritet tona sipas vendimit politik, siç është ndërrimi i misionit të Ministrisë së FSK-së, do të ketë personel shtesë, dhe se prioriteti i yni është Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes. Nga ana e Ministrisë së FSK-së, janë ndërmarrë të gjitha masat dhe janë dërguar draft-ligjet në Qeveri, duke përfshirë edhe deklaratën financiare dhe tani jemi në proces, që edhe në këtë vit të procedohen në kohë ndryshimet ligjore, sa i përket FSK-së.

Po ashtu, theksoi se si FSK, janë të gatshëm, që kurdo që merret vendimi politik, të implementojnë planin në faza. Pra, janë paraparë detyrimet, objektivat dhe qëllimet, me qëllim të implementimit që Kosova të ketë një forcë për të gjithë qytetarët.

Sa i përket objektivit të gjashtë, funksionalizimit të njësisë rajonale të kërkim-shpëtimit, janë ndërmarrë masat, pasi është dashur të koordinohet me të gjithë aktorët, ku për këtë qëllim është ofruar edhe mbështetja e disa ambasadave.

Për këtë projekt strategjik, janë zhvilluar disa aktivitete, që janë në fazat përfundimtare dhe se fillimisht do të duhet hartimi i programit trajnues dhe është duke u punuar në atë drejtim. Ndërtimi i objektit të parë, është në fazën përfundimtare, ku poligoni trajnues është me standarde evropiane. Po ashtu, është edhe Njësia e kërkim-shpëtimit (K9) , për të cilën njësi ka pasur donacione nga shteti turk dhe është një projekt që do të zhvillohet deri në vitin 2017. Kjo qendër të jetë qendër trajnuese rajonale, pra do të jetë e dyta në Evropë për këtë nivel. Po ashtu, bashkëpunimi me rajonin është shumë i mirë, me përjashtim me Serbinë dhe Bosnjë dhe

Hercegovinën, ndërsa bashkëpunimi me shtete e tjera është në fushën e shkëmbimit të informacionit, trajnimeve dhe nga komunikimi me shefat e mbrojtjes së vendeve të rajonit, është shprehur gatishmëria e tyre që të jenë pjesë e kësaj qendre trajnuese të kërkim-shpëtimit.

Ndërsa, sa i përket procesit të transformimit të FSK-së në FAK, kjo çështje do të bëhet në koordinim me të gjithë aktorët. Më tutje, theksoi prioritetet që janë për vitin 2016, ndër objektivat ka qenë dhe vazhdon të jetë mbajtja e kapaciteteve aktuale që ka FSK-ja, përgatitja për transformim dhe ngritja e njësive të para, zhvillimi i udhëheqësve, menaxhimi i burimeve njerëzore, qëndrueshmëria dhe bashkëpunimi me partnerët si dhe doktrina dhe standardizimi.

Në vazhdimësi, FSK-ja ka disa ftesa për të marrë pjesë në disa ushtrime që janë shumë të rëndësishme. Kjo i kontribuon integritetit të FSK-së në rajon dhe më gjerë. Ftesat janë nga Shqipëria, Sllovenia, ndërsa i rëndësishëm është ushtrimi që do të mbahet në Poloni, e njohur si “Anakonda”, ku 21 vende anëtare të NATO-s do të jenë pjesë e këtij ushtrimi, po ashtu edhe FSK-ja do të jetë pjesëmarrëse, me një numër të caktuar, bazuar në kapacitetet që ka. Ndërsa ftesa tjetër është “Combine Resolve” në Gjermani dhe se të gjitha këto janë të sponsorizuara nga EUKOM (Ushtria Amerikane për Evropë).

Ndërsa, FSK-ja në muajin tetor do të ketë ushtrimin fushor “Shqiponja5”, ku përveç njësive të FSK-së, ftesë i është bërë edhe Gardës Nacionale të Ajova-s.

Në mbyllje të fjalës së tij, theksoi se FSK-ja gjatë vitit 2015, duke u bazuar në objektivat dhe në direktivën, ka përmbushur misionin, qoftë në ngritje profesionale, pajisje, infrastrukturë, ndërsa objektivat e përcaktuara për vitin 2016 do të vazhdojnë, ku sfida kryesore është transformimi dhe janë vendimet politike që vendosin. Nëse mund të ketë pyetje, jam i gatshëm që të jap përgjigje.

Kryesuesi- Falënderoi për raportin e detajuar nga ana e komandantit të FSK-së. Po ashtu, theksoi se në disa raporte është kritikuar qasja e Komisionit në raport me Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në, si një qasje liberale. Fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit, për pyetje të mundshme.

Bojan Mitiq- Fillimisht, falënderoi komandantin për prezencën dhe për raportimin. Më tutje, shtroi pyetje lidhur me komunitetin serb në kuadër të FSK-së. - Sa është numri i rekrutëve të rinj të zgjedhur për vitin 2015 nga komuniteti serb? A ka qenë i përfshirë dhe në çfarë numri? Gjithashtu, sa i përket investimeve që ju theksuat, siç është shuma prej 3.2 milionë eurosh, cilat janë projektet që do të investohet? A janë kushtet e njëjta për të gjitha komunitete për të qenë pjesë e FSK-së? A është e obliguar njohja e gjuhës shqipe apo angleze për pjesëtarët e komunitetit serb?

Anton Quni- Përgëzoi gjenerallejtënant Rrahman Ramën, për punën dhe imazhin e krijuar me FSK-së dhe për imazhin e Kosovës, si dhe shprehu admirimin për kadetin Ismail Hoxha, për arritjet e tij dhe shprehu dëshirën për t’u takuar dhe biseduar me të.

Tutje theksoi se do të ngre tre çështje, dhe në rast se nuk ka informacione të mjaftueshme, mund të përgjigjet ndërkohë me shkrim.

Çështja e parë, marrë në konsideratë që në kuadër të FSK-së, ekziston një rutinë dhe standard për zhvillim në karrierë. Është fakt që, një kohë të gjatë, në nivele të larta komanduese, zyrtarët janë ende ushtrues detyre. Për këtë çështje desha të kem sqarime, ku janë problemet apo shkaqet?

Çështja e dytë, ka të bëjë me rekrutimin e pjesëtarëve të rinj të FSK-së, duke shtuar se qarkullojnë disa informata, që gjatë përzgjedhjes së kandidatëve të rinj, dominojnë kandidatët nga rajone të caktuara. Kurse nga disa rajone, sado të banuara, nuk janë përzgjedhur. Lidhur me këtë, cila është arsyeja, mungesa e interesimit, informimit?

Çështja e tretë, ka të bëjë për çështje e transformimit të FSK-së në FAK. Duke u ndërlidhur me atë çfarë tha z. Rama, “se janë në pritje të ditës D dhe të vendimit politik”, shtroi pyetjen si vijon: - Cilat janë mundësitë e FSK-së për të ndërmarrë ndonjë fushatë për të thyer paragjykimet që mund të jenë nga ana e komunitetit serb, në raport me FSK-në? A është paraparë ndonjë plan, që në kontakt me komunitetin serb, të binden që të krijohet vlerësimi real për FSK-në dhe në të ardhmen FAK?

Ganimete Musliu- Falënderoi për raportimin dhe përgëzoi për punë e bërë nga ana e gjeneralit Rama. Shtroi pyetjen: Gjatë vitit 2015, cila ka qenë sfida në planin operacional, me të cilin jeni ballafaquar?

Nuredin Ibishi- Falënderoi për raportimin dhe propozoi që në të ardhmen, të formatizohet ana e raportit, me qëllim që të ushtrojmë rolin mbikëqyrës për çështjet që janë në fushëveprimin tonë, me qëllim që të kemi një pasqyrë më të mirëfilltë rreth zhvillimit të FSK-së, në të ardhmen, FAK.

Më tutje, shtoi se duke marrë parasysh që Ministria e FSK-së dhe FSK-ja, janë në një sistem të integruar civil-ushtarak, a është menduar që në këto reforma, të përfshihet ana operationale e pjesëtarëve të FSK-së, e më pak nga pjesa mbështetëse?

A janë respektuar rregullat e Ligjit të prokurimit publik gjatë procesit të blerjes së 24 automjeteve nga ana e FSK-së?

Gjenerallejtnant Rrahman Rama- Në përgjigje të pyetjeve të deputetëve, theksoi se sa i përket numrit të minoriteteve në FSK, i shpreh në përqindje, është 8.2%. Ndërsa, vetëm nga komuniteti serb janë 47 pjesëtarë, që janë aktivë, duke mos llogaritur ata që janë në trajnim në Maqedoni. Ndërsa, sa i përket procesit të rekrutimit, theksoi se ofertat kanë qenë të njëjta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Nga ana e Zyrës për Komunitete, në kuadër të Ministrisë së FSK-së, është bërë fushatë në çdo komunë dhe se kriteret janë të njëjta dhe të bazuara në standardet e NATO-s.

Sa i përket projekteve të infrastrukturës, theksoi se 3.3 milionë janë për këto projekte dhe të gjitha projektet që janë planifikuar, kanë pasur qëllim krijimin e kushteve sa më të mira, dhe se kanë të përgatitur strategjinë për përfshirjen e komuniteteve në radhën e FSK-së.

Ndërsa, sa i përket kadetit Ismail Hoxha, ai tashmë është në trajnimin specialistik për katër muaj, dhe pas kthimit në Kosovë, mund të takohet me Komisionin. Sa i përket zhvillimit të karrierës, duke qenë se kemi qenë në pritje për procesin e transformimit të FSK-së në FAK, nuk është ngutur me implementimin e strukturës së re. Është filluar ky proces bashkërisht me ministrin dhe do të vazhdohet me krijimin e bordeve dhe të tjerave.

Sa i përket rekrutimit dhe përzgjedhjes së pjesëtarëve të rinj të FSK-së, theksoi se fushata është bërë për të gjithë dhe se ka pasur rajone me numër më të madh të aplikantëve, në krahasim me

rajone tjera dhe se mundësia e përzgjedhjes është për atë rajon që ka më shumë aplikantë, dhe se për këtë nuk ka pasur ndonjë ankesë nga ana e aplikantëve. Ndërsa, sa i përket strategjisë në raport me minoritetet, theksoi se është ndërtuar strategjia e brendshme në nivel të Ministrisë dhe është zyra në kuadër të Ministrisë, për të kontribuar në këtë drejtim. Sa i përket sfidave, theksoi se nuk ka pasur ndonjë sfidë të veçantë, përveç çështjes së transformimit të FSK-së në FAK.

Ndërsa, sa i përket çështjes se sa ligje do të ndryshohen me rastin e transformimit të FSK-së në FAK, disa nga ato 39 projektligje kanë të bëjnë vetëm me ndërrimin e emrit dhe do të bëhet deklarata financiare, ndërsa vlerësimi do të bëhet nga ana e Ministrisë së Financave. Lidhur me çështjen e forcës operationale, theksoi se struktura aktuale e FSK-së, parasheh tri njësi që do të jenë operationale: Forca tokësore, që do të jetë operationale, Komanda e logjistikës, që do të jetë mbështetëse dhe TRADOK-un, që do të bëjë përgatitjen dhe trajnimin profesional. E gjithë struktura është bazuar në një brigadë amerikane sesi funksionon, e cila është fleksibile dhe shumë më operationale.

Lidhur me zbatimin e Ligjit të prokurimit, theksoi se nuk është çështje që është në përgjegjësinë e tij, më shumë është punë administrative, por theksoi se është e bazuar në kërkesën tonë, e cila bazohet në buxhet. Më tutje, theksoi se mangësitë që ka Ligji për prokurimin publik, krijon vështirësi për të mbajtur standard, pasi ka modele ku ushtritë e modernizuara e kanë prokurimin e veçantë. Po ashtu, theksoi se në total numri i makinave të blera është 27 dhe jo 24, siç u tha nga deputeti, gjithashtu mirëmbajtja ka kosto të lartë.

Nuredi Ibishi- Lidhur me mësimin e gjuhëve të huaja, siç është mësimi i gjuhës angleze, njohjes së gjuhës shqipe nga minoritetet, shtroi pyetjen si vijon: Çfarë keni bërë në këtë drejtim?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama- Theksoi se aspekti i mësimin të gjuhëve është prioritet dhe janë katër laboratorë, si donacion nga SHBA-të dhe ka progres në këtë drejtim. Gjithashtu, janë organizuar trajnime bazike të gjuhës shqip-serbisht dhe ka iniciativa private për të mësuar gjuhën angleze.

Kryesuesi- Falënderoi komandantin për raportimin.

4. Të ndryshme

Kryesuesi- A ka ndonjë çështje për të ngritur? Nëse nuk ka, e mbyllim këtë takim.

Me këtë pikë të rendit të ditës, mbledhjen e konsideroi të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku